



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 3333/Prot.

Tiranë, më 28 . 08 . 2020

**Shpallje e kërkesës për aplikime për hartues të testeve të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor, të provimeve kombëtare të arsimit bazë, të provimeve të Maturës Shtetërore dhe vlerësues të testeve të provimeve të Maturës Shtetërore**

Qendra e Shërbimeve Arsimore shpall kërkesën për aplikime për hartues të fondit të pyetjeve që do të përdoren për hartimin e testeve të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor, të provimeve kombëtare të arsimit bazë, të provimeve të Maturës Shtetërore dhe vlerësues të përgjigjeve të nxënësve në testet e provimeve të Maturës Shtetërore.

Shpallja e kërkesës është e hapur për të gjithë të interesuarit që ushtrojnë profesionin e mësuesit, si në institucionet publike, edhe në ato private.

Kandidatët e interesuar, përpara se të fillojnë përgatitjen e dokumenteve për aplikim, duhet të sigurohen që i plotësojnë kriteret e shpallura për përzgjedhjen e kandidatëve.

**Kriteret që duhet të plotësojnë mësuesit që aspirojnë për t'u bërë hartues dhe vlerësues janë:**

Kandidati për hartimin e testeve dhe vlerësuesi në provimet/vlerësimet kombëtare është mësuesi që:

- ushtron profesionin e mësuesit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi;
- ka të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune si mësues;

- c) ka dhënë lëndën të paktën 1 (një) herë në të gjitha klasat e nivelit arsimor;
- d) ka të paktën kategorinë e kualifikimit “mësues i kualifikuar” dhe është vlerësuar në provimin e kualifikimit të mësuesve me të paktën “shumë mirë”, për hartuesit e pyetjeve, dhe me të paktën “mirë”, për vlerësuesit;
- e) ka përvojë në hartimin e pyetjeve në provimet/vlerësimet kombëtare;
- f) ka aftësi shumë të mira kompjuterike.

### **Aplikimi**

Dokumentet e nevojshme që kandidati i interesuar duhet të dorëzojë, dhe mënyra e aplikimit përcaktohet si më poshtë. Të dhënat e kandidatëve do të grumbullohen duke respektuar Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

### **Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:**

- ✓ Formular aplikimi (i cili ndodhet këtu <https://www.qsha.gov.al/forma-aplikimit/>);
- ✓ Letër motivimi e aplikantit;
- ✓ CV e aplikantit sipas modelit Europass;
- ✓ Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm;
- ✓ 2 (dy) rekomandime nga drejtues të shkollave ose specialistë të njësisë arsimore vendore për cilësinë e punës dhe qëndrimin etik;
- ✓ Vërtetim që ka 5 (pesë) vitet e fundit përvojë pune si mësues;
- ✓ Kopje të dëshmisë së provimit të kualifikimit, ku të jetë vlerësuar me të paktën “shumë mirë” për kandidatin - hartues dhe “mirë” për kandidatin - vlerësues.
- ✓ Formular vetëdeklarimi që aplikanti nuk ka qenë i dënuar penalisht;

### **Procedura e aplikimit**

Qendra e Shërbimeve Arsimore do të pranojë vetëm aplikime që janë përcjellë me postë në QSHA. Nuk pranohen aplikime dorazi.

### **Afati i dorëzimit të aplikimeve dhe procedura e vlerësimit**

Aplikimet do të drejtohen pranë QSHA, **duke filluar nga data 01.10.2020 deri më 15.10.2020**. Deri më datë 30.10.2020, do të njoftoheni në adresat tuaja elektronike, nëse jeni pranuar për të ndjekur kursin trajnues në QSHA.

Qendra e Shërbimeve Arsimore organizon procesin e vlerësimit, pranimit, regjistrimit dhe certifikimit të kandidatëve sipas rregullores “Për zhvillimin e kursit trajnues dhe të provimit për pajisjen me certifikatë të hartuesve të testeve dhe vlerësuesve të provimeve/vlerësimeve kombëtare”, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, të cilën e gjeni të publikuar në faqen e internetit të institucionit.

Kursi trajnues zhvillohet me kohë të pjeshme, pa shkëputje nga puna.

Në përfundim të kursit trajnues, kandidatët i nënshtrohen provimit për hartues dhe vlerësues. Provimi zhvillohet sipas përcaktimeve të rregullores “Për zhvillimin e kursit trajnues dhe të provimit për pajisjen me certifikatë të hartuesve dhe vlerësuesve. Një kandidat e fiton certifikatën për hartues dhe vlerësues, kur është kalues në provim.

**DREJTORE E PËRGJITHSHME**

**Rezana VRAPI**

